



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 21.07.2025
Numër Protokollit: 4902/2025

A.nr.1064/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1064/2025, të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi A.B, kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.1064/2025, e datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesi A.B.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 04.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1064/2025 dhe numër protokollit:3765/2025, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në kërkesën e tij të datës 15.04.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 09.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 12.06.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 3765/2025 të datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën Nr.14-117/01-0052615/25 e datës 15.04.2025; Listën e pagave nga thesari; Akt Emërimit Nr.01-112-1229 të datës 16.11.2024; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesë e datës 20.03.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë 09.06.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 12.06.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Zyrtar për Shërbime me Qytetarë”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e parakohshme, sepse:** Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi është i punësuar në Komunën e Prishtinës, në kuadër të Drejtorisë së Administratës, ndërsa organi i punësimit me datë 16.11.2024 i ka lëshuar Aktin e Emërimit me shifër: 01-112-1229, ashtu që pozitën e ankuesit “Zyrtar për Shërbime me Qytetar”, e ka klasifikuar në Kategorinë Profesionale 2, me klasë dhe koeficient të pagës, GJ33, 5.1.

Ankuesi, me datë 15.04.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesën Nr.14-117/01-0052615/25, për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar datë 16.11.2024 nga Komuna e Prishtinës/Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Po ashtu ankuesi në kërkesën në fjalë pretendon se është duke u paguar sipas koeficientit 4.1, ndërsa sipas shkresave të lëndës konstatohet fakti se organi i punësimit ka heshtur lidhur në kërkesën e ankuesit të datës 15.04.2025.

Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesi me datë 04.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin ankimor se i njëjti është duke u dëmtuar financiarisht, pasi që pavarësisht faktit se organi i punësimit ia ka lëshuar Aktin e Emërimit me koeficient 5.1, i njëjti nuk është duke u kompensuar sipas koeficientit të ri, më kërkesën që organi i punësimit të zbatoj aktin e emërimit me shifër: 01-112-1229 të datës 16.11.2024 dhe ta kompensojë sipas koeficientit 5.1 duke përfshirë kompensimin në mënyrë retroaktive që nga data 16.11.2024.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*”, si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: *“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, konstaton se ankesa e ankuesit e datës 04.06.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që institucioni punëdhënës lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 15.04.2025 ende nuk kishte vendosur apo nuk ka nxjerrë akt administrativ përpara se ankuesi të parashtrojë ankesë në Këshill, sikurse që nuk është përmbushur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative, pasi që institucioni punëdhënës sipas dispozitave të lartcekura ligjore ka afat kohor prej katërdhjetë e pesë (45) ditësh, për trajtimin e kërkesës së ankuesit të datës 15.04.2025, ndërsa ankuesi

ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 04.06.2025 apo në ditën e pesëdhjetë e një (51) pas parashtrimin të ankesës në institucion punëdhënës, nga rrjedh se ankuesi nuk e ka respektuar apo prit përmbushjen e parakushtit ligjor të afatit kohor “**jo më herët se shtatë (7) pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ**”, nga rrjedh se ankuesi përveç kalimit të katërdhjetë e pesë (45) ditëshit, është dashur të pres edhe shtatë (7) ditë të tjera, për të hyrë në heshtje e administrative sipas përkufizimeve ligjore të dispozitave të LPPA-së, nga rrjedh se ankuesi duhet të pres afatin e kalimit prej 52 ditësh, duke filluar nga data 15.04.2025, e pastaj nëse pas kalimit të këtij afati kohor institucioni nuk vendos lidhur me kërkesën e tij të datës 15.04.2025, atëherë të njëjtit i lind e drejta e parashtrimin të ankesës kundër heshtjes administrative nga organi i punësimit sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të LPPA-së.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimi dhe Vendosjen e Ankesave, nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 03.06.2025 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “*Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.*”

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1064/2025, datë 21/07/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.B
- Komunës së Prishtinës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Numri i lëndës: A.nr.1064/2025
Datë: 21.07.2025
Numër protokolli: 4092/2025